

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 13 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të ishte mazokizëm, një e pavërtetë turpëruese, nëse ne, shqiptarët e Shqipërisë zyrtare, akuzojmë njëri-tjetrin se nuk e duam Kosovën, dhe ende shumë më tepër nëse përgënjeshtroheshim nga fakte që do të na nxirrnin si dëmtues të kauzave të saj. Të nderuar kolegë, Nuk kam ndër mend të mbaj këtu një leksion patriotizmi, as letërsie, se zakonisht besoj më shumë te gjërat që nuk thuhet dhe te monumentet që mbeten, ndaj pak më poshtë do t'ju kujtoj katër të tillë. Ndonjëherë letërsia më ndihmon për të udhëtuar te zanafilla e krijimit të identitetit tonë, ashtu siç politika më shërben si teleskop për të kuptuar kush investon në shpërbërjen e tij dhe përse.

Vështirë të harrosh Mitrush Kutelin e “Poemit kosovar” të vitit 1943, kur i vikaste kujt të mundte kur në udhëkryq dukej fati ynë kombëtar:

“Shaban baba,

Destan vëlla,

Jam kosovar pra jam shqiptar:

Zot e krenar,

Zot e bujar mbi këtë dhé,

që e kam si fe”;

Lasgush Poradecin, i cili përlotej për Kosovën tek recitonte vetveten përkundruall liqenit, që pati qenë i yni dhe tokat tona ndante:

“Kosova që bën sulm në zjarr

Porsi dragonj me fletë,

Siç bënte sulm ngadhëgimtar

Gjergj Kastrioti vetë”;

Ismail Kadarenë, në vitin 1982, kur rinia e demonstratave shtypej me tanke, të cilin vetëdija e ekzistencës të Gjergj Kastrioti e shpinte:

“S’kish dëshmitarë, TV nuk pati

Zinxhiri i tankut kur ju griu,

Por retë e globit veç ju panë,

Ndërgjegje e botës të ju mbërriu”;

dhe në fund dëshmitarin e epërm të Kosovës, Ali Podrimjen, një bard, orakull i patejkalueshëm i tokës së tij, kur penda ngjyhej në gjak dhe vetëm fjalët përkufizonin, ëndrrat mbeteshin të lira: “Unë, biri yt, Kosovë, t’i njoh dëshirat e heshtura, t’i njoh ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj...”!

E di, do të thoni: “Po ky ç’pati?! Poezi e di politikën dhe sallën e Kuvendit, klub vjershash?!”. Jo, për asnjë çast nuk e kam këtë naivitet. Edhe pse dua, realiteti i kësaj salle më pengon. Dua t’ju kujtoj se Shqipërinë dhe Kosovën, atë që ka filluar të loti si robëri, e gjaku si liri, e kanë bërë të parët poetët, më pas luftëtarët e diplomatët dhe në fund i kanë kthyer të dyja në milet bahçe personale politikanët. Dashurinë për Kosovën njerëzit e heshtur të këtij vendi e kanë përjetuar herë si dhimbje e herë si gëzim, herë si faj e herë si mungesë, herë si brengë e herë si krenari, herë si copëtim trupi, e në fund të historisë si fitore!

Ajo që ne i kemi borxh Kosovës nuk është vetëm falja për tradhtinë e vitit 1945, për brigadat partizane, që u bënë një me ato të Titos për të shtypur rezistencën e Shaban Polluzhës me shokë; jo vetëm ndjesa për masakrën e Tivarit, ku mijëra djem, “lulet” e Kosovës, kaluan nëpër territorin e shtetit tonë për t’u vrrarë në Malin e Zi dhe ne heshtëm për dekada, të frikur nga

terrori e të verbuar nga opiumi ideologjik; jo vetëm kur i quanim “miq” kosovarët dhe “vëllezër” kinezët (duhet të ndihemi ligisht), as vetëm për spiunimet që u bënë intelektualëve të tyre kur vinin në Tiranë dhe, sigurisht, as vetëm për burgosjen e persekutimin si mikpritje kur kalonin kufirin në kërkim të lirisë në shtetin amë, as vetëm për përbuzjen krahinore e dialektore, që shpesh e shfaqim në media e spektakle, as vetëm për termin “malok” (duhet të skuqemi), po më shumë për kundërvënien e Adem Demaçit ndaj prijësit Ibrahim Rugova, për etiketimin e tij “tradhtar” nga ministrat shqiptarë, duke ndarë atë që populli i Kosovës kishte bashkuar vetëdijen e tij, e shumë më tepër për trajtimin e Kosovës si gur shahu në lojën e përditshme të politikës sonë, për abuzimin me të për kredo politike, për akuzat në lidhje me të, se kush është patrioti e kush tradhtari, për t’i vënë stërkëmbës kundërshtarit me emrin “Kosovë” e “kosovar” në gojë, si salsiçe apo suxhuk, për dëshirën për t’i përdorur politikanët e saj, shkrimtarët e saj si mbështetje politike në Shqipëri, për drekat e darkat me ta po kaq.

Ne e kemi ndihmuar Kosovën tashmë prej 32 vjetësh sa e si kemi ditur, i kemi pritur ata gjatë eksodit biblik sa kemi mundur, edhe pse te rraskapitur për vete, e po në të njëjtën kohë politikani shqiptar është munduar t’i vjedhë imazhin Kosovës dhe si qeleshe patriotizmi ta vendosë në kokën e vet me cepa. Ndoshta për këtë Kosovës duhet t’i kërkojmë falje. Nuk besoj shumë te folklori, te fuqia dhe larja e gojës së rezolutave tona, që shpesh duken si decibao kineze të revolucionit kulturor, por do ta votoja një të tillë si falje për dëmet dhe hipokrizinë. Dje, në asamblenë e Këshillit të Europës, u fol për Kosovën dhe kjo tregon se Kosova është shenjë në ndërgjegjen e tij.

Foli dhe Kryeministri i Shqipërisë, i cili është kundërshtari im politik, që çdo ditë që ai qeveris këtë vend e konsideroj tejkalim të së drejtës, por fjalimi i tij, atje, për raportin e Dik Martit, nuk mund të kritikohet lehtë, ndoshta është më i kalkukuari që ai ka mbajtur, por, nga ana tjetër, në këta 9 vjet ai ka marrëdhëniet më të këqija me kryeministrat e Kosovës dhe një nivel formal bashkëpunimi të çdo natyre. Ne vajtuam me zemër për tragjeditë e mëdha të Kosovës, për heronjtë e saj si Adem Jashari e shumë të tjerë, dhuruam armë e çka mundëm, por tentuam edhe t’i vjedhim fitoren edhe t’i pengojmë marrëveshjet, ndonëse e gjetëm forcën të brohorasim: “Një komb, një qëndrim”.

Edhe sot ne e kemi këtë fuqi, që nga kjo sallë bazike e politikës të brohorasim: “Një komb, një qëndrim, gjithmonë”. Frustrim i madh ta pranosh që, që nga viti 1974 deri në vitin 1982, Shqipëria dhe Kosova, në nivel akademik e kulturor, kanë pasur marrëdhënie më intensive se sot! Çfarë na pengon sot? Thyejmë arra me gojë gjithë ditën për patriotizëm, nacionalizëm, çojmë dorën tek alltia kur këndojmë: “Xhamadani vija-vija, jam Kosova, jam Shqipëria”, por bashkëpunimi mes universiteteve tona është tejet i ulët dhe “Open Ballkan” i atakuar nga politika gjermane i ndjell Kosovës rrezikun e ri të vasalitetit.

Kosova nuk ka nevojë për paternalizëm, as për folklor, për hipokrizi e përdorim jo e jo, por së paku për ortak të ndershëm, se një fjalë e urtë popullore thotë: “Vëllai kur rritet të bëhet ortak në fisin e madh të racës shqiptare!”. Faleminderit!